




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shërbimeve Publike - Ministarstva Javnih Sluzbi - Ministry of Public Services

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Bruto Produkti Vendor 2004 - 2007



Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shërbimeve Publike - Ministarstva Javnih Sluzbi - Ministry of Public Services

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Bruto Produkti Vendor 2004 - 2007



Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo

Botuesi: Enti i Statistikës së Kosovës (ESK)

Data e botimit: Prill 2009

© : Enti i Statistikës së Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ESK-së
në internet: www.ks-gov.net/esk

P a r a t h ë n i e

Enti i Statistikës së Kosovës (ESK) ka përpiluar të dhënat provizionale të Bruto Produktit Vendor (BPV) për vitet 2004-2007, me qasjen e shpenzimeve. BPV është përlogaritur në bazë të parimeve metodologjike të Sistemit Evropian të Llogarive ("European System of Accounts" - ESA 95).

Te dhënat nga Llogaritë Kombëtare përdoren për planifikim ekonomik dhe fiskal dhe për elaborimin e programeve të zhvillimit për sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Rezultatet nga llogaritë kombëtare përdoren po ashtu nga investitorët e vendit dhe të huaj, për të vlerësuar situatën ekonomike të shtetit dhe mundësitë për investime të reja.

ESK do të vazhdojë zhvillimin e Llogarive Kombëtare në pajtim me rekomandimet ndërkombëtare dhe do të publikojë të dhëna kualitative dhe me kohë.

Ky publikim është përgatitur nga stafi i llogarive kombëtare: Ilir T. Berisha-Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Xhevdet Fetahu, Shqiponjë Bektashi, Ylli Shala, dhe Ilir Mazrekaj.

Falënderojmë në veçanti Velitchka Petrova, eksperte e FMN-së.

Falënderojmë Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, Ministrinë e Shërbimeve Publike (sektori i OJQ-ve) dhe agjensionet tjera për bashkëpunim.

Komentet dhe sugjerimet tuaja janë të mirëseardhura.

Prishtinë, prill 2009

Kryeshefi Ekzekutiv i ESK-së,
z. Avni Kastrati

Shkurtesat

ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
ESA	Sistemi Evropian i Llogarive (European System of Accounts)
SNA	Sistemi i Llogarive Kombëtare (System of National Accounts)
BPV	Bruto Produkti Vendor
ABESH	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Shtëpiake
SHKESH	Shpenzimet e konsumit te ekonomive shtëpiake
IJPSHESH	Institucionet jo-profitabile të cilat u shërbejnë Ekonomive Shtëpiake (Non profit institutional serving household)
COICOP	Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit
FBK	Formimi i Bruto Kapitalit
FKFB	Formimi Bruto Kapitalit Fiks
KFQ	Konsumi Final i Qeverisë
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
ABESH	Anketa Bujqësore e Ekonomive Shtëpiake
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
BoP	Bilanci i Pagesave
OJQ	Organizatat jo Qeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale te Kosovës
CIF	Kostoja, sigurimi, transporti
FOB	I lirë nga dogana
IÇK	Indeksi i çmimeve te konsumit
IVN	Indeksi i vlerës njësi
:	Shifrat mungojnë
-	Nuk aplikohet

P ë r m b a j t j a

	Faqe
I. Hyrje.....	5
II. Bruto produkti vendor me çmime aktuale	5
III. Pjesët përbërëse të Bruto Produktit Vendor.....	9
1. Konsumi final i ekonomive shtëpiake.....	9
Tabela 6: Konsumi privat i ekonomive shtëpiake - koncepti vendor	11
2. Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë së Përgjithshme	11
Tabela 7: Shpenzimet e Konsumit Final të Qeverisë së Kosovës	11
3. Formimi i bruto kapitalit (FBK)	12
Tabela 8: Formimi i bruto kapitalit 2004-2007	12
4. Konsumi final i institucioneve jo profitabile të cilat iu shërbejnë ekonomive shtëpiake (KF i IJPSHESH)	13
Tabela 9: Shpenzimet e konsumit final të Institucioneve jo-profitabile, të cilat iu shërbejnë.....	13
ekonomive shtëpiake.....	13
5. Importi dhe eksporti i mallrave dhe shërbimeve	13
IV. Shënime Metodologjike:.....	14
Shtojca Nr. 1: Vlerësimi i konsumit privat të ekonomive shtëpiake	17
I. Metodologjia.....	17
Të dhënat e importit/ eksportit	18
Të dhënat e bujqësisë.....	18
Të dhënat nga tatimet	18
II. Vlerësimi i Konsumit të Ekonomive Shtëpiake	19

I. Hyrje

Bruto Produkti Vendor në Kosovë për vitet 2004-2007 (me qasjen e shpenzimeve)

Republika e Kosovës ka filluar procesin e organizimit të shtetit dhe të përcjelljes së strategjisë ekonomike të nevojshme për zhvillimin e mëtutjeshëm. Në këto kushte, është më se e domosdoshme të kemi informata rreth vlerave dhe rritjes së Bruto Produktit Vendor (BPV) si dhe të dhëna tjera të grupuara të Llogarive Kombëtare. Sipas rekomandimeve, koncepti i Sistemit të Llogarive Kombëtare paraqet një kornizë të gjerë, e cila në mënyrë të saktë dhe të besueshme mundëson krahasimin e informatave të marra nga burime të ndryshme dhe të dhënave të grupuara nga sektorët e ndryshëm të ekonomisë. Qëllimi i këtij sistemi është paraqitja e pasqyrës së përgjithshme të ekonomisë së shtetit përmes indikatorëve të krahasueshëm.

Aplikimi i sistemit ndërkombëtar të Llogarive Kombëtare është shumë i ndërlikuar. Aplikimi i plotë i kësaj metodologjie varet nga zhvillimi i vet sistemit statistikor dhe ekonomisë së Kosovës. Nisur nga kjo, Sistemi i Llogarive Kombëtare duhet të harmonizohet me kërkesat ndërkombëtare.

II. Bruto produkti vendor me çmime aktuale

Treguesi kryesor dhe më i rëndësishëm makroekonomik në Sistemin e Llogarive Kombëtare është Bruto Produkti Vendor (BPV), i cili paraqet rezultatet e aktiviteteve prodhuese të të gjitha njësive rezidente institucionale.

Kalkulimi i Bruto Produktit Vendor, në pajtim me metodologjinë e ESA 95, i përdorur për vitet 2004-2007, bazohet në burimet e të dhënave administrative ekzistuese si dhe në anketat statistikore zyrtare, të cilat realizohen në ESK. Numri dhe përmbajtja e këtyre anketave akoma nuk i përmbushin objektivat e statistikave të Llogarive Kombëtare, për plotësimin e kërkesave dhe implementimin e plotë të metodologjisë ndërkombëtare të përmendur më lartë.

BPV në Kosovë për vitet 2004-2007 është rritë në vlerën prej 3.006,5 në 3.433,6 milion euro. BPV për kokë banori është rritë me të njëjtin trend, prej 1.473 euro në vitin 2004 , në 1.612 euro në vitin 2007.

Tabela 1 - BPV me çmime aktuale (Të dhënat provisionale)

	(në milion Euro)			
	2004	2005	2006	2007
BPV me çmime aktuale	3.006,1	3.068,3	3.191,6	3.433,6
Shpenzimet e konsumit final	3.298,1	3.434,6	3.560,3	3.913,1
Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake	2.539,1	2.705,7	2.864,7	3.248,4
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	735,5	705,2	670,8	641,6
Qeveria e Kosovës	355,5	329,2	340,8	327,3
Donatorët (pagat)*	380,0	376,0	330,0	314,4
Të punësuar të huaj	248,0	258,0	213,0	196,9
Të punësuar vendor	132,0	118,0	117,0	117,4
Shpenzimet e konsumit final të IJPSHESH	23,5	23,7	24,8	23,1
Formimi i bruto kapitalit	701,3	722,2	798,3	892,6
Formimi i bruto kapitalit fiks	583,6	592,8	657,1	744,3
Ndryshimet në inventar	117,7	129,4	141,2	148,3
Eksporti neto	-993,3	-1.088,6	-1.166,9	-1.372,0
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	212,4	214,7	285,6	356,8
Eksporti i mallrave	56,9	56,3	110,8	165,1
Eksporti i shërbimeve	155,5	158,4	174,8	191,7
Importi i mallrave dhe shërbimeve	1.205,7	1.303,3	1.452,5	1.728,8
Importi i mallrave	1.028,7	1.100,2	1.251,9	1.506,2
Importi i shërbimeve	177,0	203,1	200,6	222,6
Popullsia (000)¹	2.041	2.070	2.100	2.130
BPV për kokë banori (Euro)	1.473	1.482	1.520	1.612

* Përfshinë pagat e të punësuarve rezident të UNMIK-ut (pagat e të huajve, të cilët qëndrojnë më gjatë se një vit në Kosovë, stafit lokal të cilët punojnë në UNMIK, KFOR dhe organizata tjera); shih shtojcën 2.

¹www.ks-gov.net/esk Statistikat Vitale të Kosovës.

Komponenti kryesor i Bruto Produktit Vendor është konsumi final i ekonomive shtëpiake, i cili është rritë nga 2.539,5 milion euro në vitin 2004 në 3248,4 milion euro në vitin 2007. Konsumi është bazuar në pjesën më të madhe në importin e mallrave dhe shërbimeve. Kjo i kontribuon konsumit gjithsej të popullsisë, afërsisht 50%.

Formimi i bruto kapitalit (FBK) në përgjithësi merr pjesë me 26% në Bruto Prodhimin Vendor për vitin 2007.

Shpenzimet e Qeverisë Qendrore në vitin 2004 marrin pjesë me 24,5% në Bruto Prodhimin Vendor, ndërsa me 18,7% në vitin 2007.

Tabela 2: Struktura e BPV sipas shpenzimeve (%)

	2004	2005	2006	2007
BPV me çmime aktuale	100.0	100.0	100.0	100.0
Shpenzimet e konsumit final	109.7	111.9	111.5	114.0
Shpenzimet e konsumit final te ekonomive shtëpiake	84.5	88.2	89.8	94.6
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	24.5	23.0	21.0	18.7
Qeveria e Kosovës	11.8	10.7	10.7	9.5
Donatorët (pagat)	12.6	12.3	10.3	9.2
Të punësuar te huaj	8.2	8.4	6.7	5.7
Të punësuar vendor	4.4	3.8	3.7	3.4
Shpenzimet e konsumit final të IJPSHESH	0.8	0.8	0.8	0.7
Formimi i bruto kapitalit	23.3	23.5	25.0	26.0
Formimi i bruto kapitalit fiks	19.4	19.3	20.6	21.7
Ndryshimet në inventar	3.9	4.2	4.4	4.3
Eksporti neto	-33.0	-35.5	-36.6	-40.0
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	7.1	7.0	8.9	10.4
Eksporti i mallrave	1.9	1.8	3.5	4.8
Eksporti i shërbimeve	5.2	5.2	5.5	5.6
Importi i mallrave dhe shërbimeve	40.1	42.5	45.5	50.3
Importi i mallrave	34.2	35.9	39.2	43.9
Importi i shërbimeve	5.9	6.6	6.3	6.5

Vlera nominale e Bruto produktit vendor është rritë 7,6% në mes viteve 2007 dhe 2006. Një rritje të rëndësishme e kishte Formimi i bruto kapitalit , i cili shprehur në vlerën nominale në vitin 2007 në krahasim me vitet e më parme është rritë për 11,8%. Edhe pse pjesëmarrja e eksportit në Bruto produktin vendor është shumë e vogël, duhet te theksohet se kishte një rritje domëthënëse në vitin 2007.

Tabela 3: Shkalla e rritjes nominale (%)

	2005/2004	2006/2005	2007/2006
BPV me çmime aktuale	2.1	4.0	7.6
Shpenzimet e konsumit final	4.1	3.7	9.9
Shpenzimet e konsumit final te ekonomive shtëpiake	6.6	5.9	13.4
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	-4.1	-4.9	-4.4
Qeveria e Kosovës	-7.4	3.5	-4.0
Donatorët (pagat)	-1.1	-12.2	-4.7
Të punesuar te huaj	4.0	-17.4	-7.6
Të punesuar vendor	-10.6	-0.8	0.3
Shpenzimet e konsumit final të IJPSHESH	0.9	4.6	-6.9
Formimi i bruto kapitalit	3.0	10.5	11.8
Formimi i bruto kapitalit fiks	1.6	10.8	13.3
Ndryshimet në inventar	9.9	9.1	5.0
Eksporti neto	9.6	7.2	17.6
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	1.1	33.0	24.9
Eksporti i mallrave	-1.1	96.8	49.0
Eksporti i shërbimeve	1.9	10.4	9.7
Importi i mallrave dhe shërbimeve	8.1	11.4	19.0
Importi i mallrave	7.0	13.8	20.3
Importi i shërbimeve	14.7	-1.2	11.0

III. Pjesët përbërëse të Bruto Produktit Vendor

1. Konsumi final i ekonomive shtëpiake

Konsumi final i ekonomive shtëpiake është komponenti kryesor i Bruto Produktit Vendor me qasjen e shpenzimeve dhe paraqet shpenzimet e ekonomive shtëpiake rezidente, me qëllim të plotësimit të nevojave dhe kërkesave të tyre për mallra dhe shërbime. Kjo nuk nënkupton vetëm mallrat dhe shërbimet e paguara direkt, por gjithashtu edhe marrjen (përvetësimin) e tyre edhe në natyrë ose nga prodhimi vetanak.

Vlerësimi i shpenzimeve të ekonomive shtëpiake është bazuar në të dhënat e anketës së buxhetit të ekonomive shtëpiake (ABESH) . Kjo anketë organizohet në ESK, por kualiteti i të dhënave të saj është i ndikuar nga mungesa e regjistrimit të popullsisë, (i cili është i nevojshëm për nxjerrjen e mostrës) dhe paraqitjes së nën raportimit të dukshëm.

Për të plotësuar kërkesat e ESA 95 dhe për vlerësimin më të saktë të Bruto produktit vendor, ESK ka zhvilluar një aktivitet të gjerë për vlerësimin e konsumit të ekonomive shtëpiake. Rezultatet janë bazuar në të dhënat e anketës së ekonomive shtëpiake, por janë përmirësuar me metodën e ekstrapolimit, e cila është bërë në tre hapa:

- të gjitha përgjigjet janë filtruar duke i përjashtuar përgjigjet me kualitet jo të mir;
- rezultatet e fituara janë agreguar për secilin artikull dhe janë ngritë me numrin e gjithsej të popullsisë;
- rezultatet e agreguara për secilin grup mallrash janë plotësuar me të dhëna nga burime tjera të të dhënave, si: të dhënat nga importi, të dhënat nga bujqësia, të dhënat nga tatimet, të dhënat nga kompanitë e mëdha, etj.

Supozimi kryesor për kalkulime përfshinë limitin e caktuar për minimumin e konsumit të ushqimit prej 35€ në muaj për kokë banori dhe me më shumë se 2,100 kcal ushqim për kokë banori brenda ditës. Për të vlerësuar konsumin e përgjithshëm, vlerësimet për kokë banori janë shumëzuar për numrin e gjithsej të popullsisë. Numri gjithsej i popullsisë për vitet 2004-2007 ishte: në vitin 2004-2.041 milion banorë; në vitin 2005 – 2.070 milion, në vitin 2006 –2.100 milion banorë dhe në vitin 2007-2.130 milion banorë.

Tabela 4. Konsumi privat i ekonomive shtëpiake

(në milion Euro)

Nr.	Përshkrimi	2004		2005		2006		2007	
		Gjithsej	prej të cilave importi ^{/2}	Gjithsej	prej të cilave importi ^{/2}	Gjithsej	prej të cilave importi ^{/2}	Gjithsej	prej të cilave importi ^{/2}
	Gjithsej konsum	2,489.1	1,110.2	2,648.2	1,235.1	2,805.2	1,338.5	3,187	1,581
1	Gjithsej ushqimi	1,012.2	357.0	1,022.8	356.9	1,079.9	395.0	1,973	1,119
2	Gjithsej jo ushqimore	1,476.9	753.2	1,625.4	878.3	1,725.3	943.5	1,214	462
3	Alkoholi dhe duhani	127.0	115.0	115.4	104.5	146.1	133.0	185	171
4	Veshjet dhe mbathjet	89.7	82.0	106.9	98.5	131.5	127.0	147	142
5	Banimi	501.8	7.0	522.2	11.7	540.2	16.0	579	23
6	Mobilimi	170.0	165.0	190.9	185.9	226.5	221.5	275	270
7	Shëndetsia	47.5	40.0	44.5	36.7	45.7	38.0	48	38
8	Transporti	295.7	271.6	372.0	348.5	337.4	310.0	369	336
9	Komunikimi	66.0	2.6	81.0	12.0	98.0	9.0	119	18
10	Rekreacioni dhe kultura	73.0	56.0	77.4	60.1	84.4	64.0	113	92
11	Edukimi	14.8	0.0	14.7	0.0	18.4	0.0	30	0
12	Hotelet dhe restorantet	40.7	0.0	41.5	0.0	39.4	0.0	41	0
13	Te ndryshme	50.6	14.0	58.9	20.3	57.7	25.0	67	28

Burimi: ESK, ABESH, dhe vlerësimet e FMN

2/ Importi I vlerësuar me çmime blerëse (përfshirë taksat dhe marzhën tregtare).

Tabela 5: Pjesëmarrja e importit dhe prodhimit vendor në përqindjen e konsumit final të ekonomive shtëpiake (%)

Përshkrimi	2004		2005		2006		2007	
	Gjithsej	Importi ^{/3}	Gjithsej	Importi ^{/3}	Gjithsej	Importi ^{/3}	Gjithsej	Importi ^{/3}
Gjithsej konsum	100,0	44,6	100,0	46,6	100,0	47,7	100,0	49,6
Gjithsej ushqimi	100,0	35,3	100,0	34,9	100,0	36,6	100,0	56,7
Gjithsej jo ushqimore	100,0	51,0	100,0	54,0	100,0	54,7	100,0	38,0
Alkoholi dhe duhani	100,0	90,5	100,0	90,6	100,0	91,0	100,0	92,7
Veshjet dhe mbathjet	100,0	91,5	100,0	92,2	100,0	96,6	100,0	96,8
Banimi	100,0	1,4	100,0	2,2	100,0	3,0	100,0	4,0
Mobilimi	100,0	97,1	100,0	97,4	100,0	97,8	100,0	98,2
Shëndetsia	100,0	84,1	100,0	82,6	100,0	83,2	100,0	79,8
Transporti	100,0	91,8	100,0	93,7	100,0	91,9	100,0	91,0
Komunikimi	100,0	4,0	100,0	14,8	100,0	9,2	100,0	15,3
Rekreacioni dhe kultura	100,0	76,7	100,0	77,6	100,0	75,9	100,0	81,3
Edukimi	100,0	0,0	100,0	0,0	100,0	0,0	100,0	-
Hotelet dhe restorantet	100,0	0,0	100,0	0,0	100,0	0,0	100,0	-
Te ndryshme	100,0	27,7	100,0	34,4	100,0	43,4	100,0	42,2

3/ Importi i vlerësuar me çmime blerëse (përfshirë taksat dhe marzhën tregtare).

Tabela 6: Konsumi privat i ekonomive shtëpiake - koncepti vendor

	2004	2005	2006	2007	
Konsumi i ekonomive shtëpiake- koncepti vendor	2,489	2,648	2,805	3,187	
+Konsumi i rezidentëve jashtë shtetit	51.0	56.4	61.9	64.9	
- Konsumi i jo- rezidentëve në Kosovë	26.6	25.9	25.8	25.9	
+ Konsumi lokal i të huajve, të cilët konsiderohen rezident	26.0	27.1	23.4	22.4	
Konsumi i ekonomive shtëpiake – koncepti kombëtar	1+2-3+4	2,539	2,706	2,864	3,248

Duke u bazuar në definicionet e SNA 93 (System of National Accounts – Sistemi i Llogarive Kombëtare), konsumi final i ekonomive shtëpiake përfshinë edhe shpenzimet e shkaktuara jashtë vendit si dhe shpenzimet e të huajve rezident (të cilat nuk janë të përfshira në ABESH). Llogaritja e konsumit final të ekonomive familjare është shndërruar nga koncepti i brendshëm në atë kombëtar duke i shtuar shpenzimet e ekonomive familjare jashtë vendit dhe duke i zbritur shpenzimet e jo-rezidentëve në territorin brendshëm, ashtu siç është e regjistruar ne Bilancin e Pagesave. Për më tepër është shtuar konsumi i të huajve rezident. Bazuar në marrëveshjen gjatë misionit të FMN lidhur me Bilancin e Pagesave (Korrik 2007), konsumi lokal i të huajve rezident korrespondon me 14 për qind të pagave të të huajve rezident.

2. Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë së Përgjithshme

Konsumi final i Qeverisë përbëhet nga shuma e mallrave dhe shërbimeve të blera, kompensimi i punëtorëve dhe konsumit të kapitalit fiks (output jo për shitje), i zvogëluar për të hyrat nga shitjet (prodhim për treg).

Tabela 7: Shpenzimet e Konsumit Final të Qeverisë së Kosovës

Përshkrimi	(në milion Euro)							
	2004		2005		2006		2007	
	Përgjithshme	Qendrore	Përgjithshme	Qendrore	Përgjithshme	Qendrore	Përgjithshme	Qendrore
OUTPUT gjithsej (2+3)	364.4	234.7	337.4	213.2	353.8	224.8	344.4	216.6
Prodhimi jo për treg	334.1	215.7	306.1	192.8	316.0	195.2	300.8	175.5
Prodhimi për treg	30.3	19.1	31.3	20.3	37.8	29.6	43.6	41.2
Konsumi i ndërmjetëm	160.4	115.6	104.3	82.2	134.1	106.6	119.2	93.8
Bruto vlera e shtuar (1-4)	204.0	119.1	233.1	131.0	219.7	118.1	225.2	122.9
Konsumi i kapitali fiks	21.4		23.1		24.8		26.5	
Konsumi final i Qeverisë								
(2+6)	355.5		329.2		340.8		327.3	

Vërejtje: Në konsumin final të Qeverisë nuk janë përfshirë grantet e dedikuara te donatoreve (GDD) dhe donacionet ne natyrë

3. Formimi i bruto kapitalit (FBK)

Bazuar në metodologjinë e ESA 95, formimi i bruto kapitalit paraqet shumën e formimit të bruto kapitalit fiks dhe ndryshimeve në inventar.

Formimi i bruto kapitalit fiks (FBKF) paraqet vlerën e mallrave afatgjate të nevojshme të fituara nga njësitë rezidente , të cilat përdoren në mënyrë të përsëritur ose vazhdimisht në procesin tjetër të prodhimit për më shumë se një vit, si dhe vlerën e mallrave dhe shërbimeve të inkorporuara në vlerën e kapitalit fiks të mallrave të nevojshme.

Për shkak të faktit se prodhimi vendor nuk është aq i zhvilluar, burimi kryesor i të dhënave për investime janë të dhënat nga importi. Në këto kushte, vlerësimi i Formimit të bruto kapitalit fiks është bërë duke i marrë të dhënat nga importi për makineri dhe pajisje. Vlera e ndërtimeve është bazuar në vlerën e materialit bazë të prodhuar në këtë aktivitet , qoftë ai i importuar si dhe ai i prodhuar në Kosovë.

Vlerësimi i ndryshimeve në inventar është bazuar në rezultatet e Anketës strukturore të ndërmarrjeve, e realizuar nga ESK dhe sipas supozimeve metodologjike të zhvillimit ekonomik.

Tabela 8: Formimi i bruto kapitalit 2004-2007

Nr.	Përshkrimi	2004	2005	2006	2007
1	Makineria dhe Pajisjet - import (2+3)	144,9	109,5	124,4	161.4
2	Mallrat Kapitale (përveç mjeteve transportuese)	128,9	86,0	101,1	92
3	Pajisjet dhe Pjesët e transportit	16,1	23,5	23,2	25.6
4	Ndërtimtaria	438,6	483,3	532,7	583
5	Formimi Bruto i Kapitalit Fiks (1+4)	583,6	592,8	657,1	745
6	Stoqet	117,7	129,4	141,2	160,0
7	Formimi Bruto i Kapitalit (5+6)	701,2	722,2	798,3	905

4. Konsumi final i institucioneve jo profitabile të cilat iu shërbejnë ekonomive shtëpiake (KF i IJPSHESH)

Konsumi final i institucioneve jo profitabile të cilat iu shërbejnë ekonomive shtëpiake përfshinë kompensimin e punëtorëve dhe blerjet e mallrave dhe shërbimeve , të zvogëluara për çfarëdo marrje nga shitjet e mallrave dhe shërbimeve, të cilat mund të jenë të përfshira në konsumin final të ekonomive shtëpiake.

Në vlerësimet e BPV për vitet 2004-2007, institucionet jo profitabile të cilat iu shërbejnë ekonomive shtëpiake përbëhen nga Partitë politike dhe Organizatat jo qeveritare(OJQ). Për shkak të natyrës së ndryshme të organizatave të cilat e përbëjnë këtë sektor, vlerësimet janë bazuar në burime të ndryshme të të dhënave, si : OSBE, Ministria e Shërbimeve Publike, etj. Indikatorët kryesor janë të paraqitur në Tabelën 9.

Tabela 9: Shpenzimet e konsumit final të Institucioneve jo-profitabile, të cilat iu shërbejnë ekonomive shtëpiake

Nr	Përshkrimi	2004	2005	2006	2007
1	Prodhimi (output)	23.54	24	25	23
2	Konsumi i ndërmjetëm	9.92	9	10	9
3	Bruto vlera e shtuar (1-2)	13.62	14.26	14.9	14.1

5. Importi dhe eksporti i mallrave dhe shërbimeve

Udhëzuesi i Bilancit të pagesave të FMN (BPM5) e definojnë shit-blerjen e mallrave si: komercializimi i mallrave (me disa përjashtime). Kjo është për shkak se mallrat e lëvizshëm, për të cilët ndryshimet reale apo të përlogaritura të pronësisë shfaqen në mes të rezidentëve dhe jo rezidentëve.

Definicioni i bilancit të pagesave të FMN është plotësisht konsistent me definicionin e ESA 95 për tregtinë e mallrave, i cili na mundëson që të dhënat e bilancit të pagesave të përdoren në mënyrë të drejtpërdrejtë në llogaritë kombëtare në Kosovë.

Të dhënat statistikore të tregtisë së mallrave të mbledhura në ESK janë të marra nga të dhënat e Doganës. Te dhënat e importit dhe eksportit të shërbimeve janë marrë nga BQK.

IV. Shënime Metodologjike:

BPV është treguesi kryesor i Llogarive kombëtare, i cili paraqet rezultatet finale të prodhimit në të gjitha aktivitetet e njësive prodhuese rezidente. BPV mund të llogaritet sipas këtyre qasjeve:

Qasja e prodhimit:

$$BPV = BVSH + TP - SP$$

BPSH = Bruto vlera e shtuar

TP = tatimet në produkte

SP = subvencionet në produkte

Qasja e shpenzimeve:

$$BPV = KF + FKB + (E-I)$$

KF = konsumi final

FKB = formimi i kapitalit bruto

E = eksporti

I = importi

Qasja e të ardhurave:

$$BPV = KP + TTP - STP + TOB + TP - SP$$

KP = kompensimi i punëtorëve

TTP = tatimet tjera në prodhim

STP = subvencionet tjera në prodhim

TOB = teprica operative bruto

TP = tatimet në prodhim dhe import

SP = subvencionet në prodhim dhe import

Burimet e të dhënave:

Vlerësimi i Bruto produktit vendor me qasjen e shpenzimeve është bazuar në këto burime kryesore të të dhënave:

a) Burimet statistikore të të dhënave:

-Rezultatet e anketave të kryera nga ESK, si: anketa e buxhetit të ekonomive shtëpiake (ABESH), anketa e fuqisë punëtore (AFP), anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore (AESHB) dhe publikimet e ESK;

-Të dhënat e tregtisë së jashtme : importi dhe eksporti i mallrave;

-Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK), i organizuar për çdo muaj nga ESK;

-Indeksi i vlerës njësi (IVN), i cili përdoret për eksport dhe import , i kalkuluar në ESK.

b) Burimet administrative:

-Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF), sa i përket të dhënave të buxhetit dhe të thesarit;

-Banka Qendrore e Kosovës (BQK), sa i përket të dhënave të Bilancit të pagesave (BoP);

-OSBE sa i përket të dhënave të Partive Politike;

-Ministria e Shërbimeve Publike sa i përket të dhënave të Organizatave jo qeveritare (OJQ).

Qasja e shpenzimeve:

Bruto produkti vendor (BPV) sipas qasjes së shpenzimeve është shuma e të gjitha shpenzimeve finale të mallrave dhe shërbimeve. Këto shpenzime ndahen në tri grupe kryesore : konsumi final (KF), formimi i kapitalit bruto (FKB), dhe neto eksporti dhe importi (E-I). Meqë bruto prodhimi vendor (BPV) matë prodhimin e brendshëm, vlera e të gjitha shpenzimeve të importit zbritet nga të gjitha shpenzimet duke përdorë formulën:

$$\text{BPV} = \text{KF} + \text{FKB} + (\text{E-I})$$

A. Konsumi final (KF)

$$\text{KF} = \text{KFESH} + \text{KF i IJPSHESH} + \text{KFAQ}$$

Konsumi final është shuma e konsumit final të ekonomive shtëpiake (KF ESH), konsumit final të institucioneve jo profitabile të cilat iu shërbejnë ekonomive shtëpiake (KF i IJPSHESH) dhe konsumit final aktual të Qeverisë (KFAQ).

Konsumi final i ekonomive shtëpiake (KFESH)

KFESH është vlerësuar si shumë e konsumit të ekonomive shtëpiake rezidente në Kosovë, duke i shtuar blerjet e mallrave dhe shërbimeve në botën e jashtme nga ekonomitë shtëpiake rezidente (import i shërbimeve në Kosovë) dhe duke i zbritur blerjet e mallrave dhe shërbimeve nga ekonomitë shtëpiake jo rezidente në Kosovë (eksport i shërbimeve).

Konsumi i gjithsej final i ekonomive shtëpiake rezidente në Kosovë është marrë nga anketa e buxhetit familjar të ekonomive shtëpiake (ABFESH) dhe nga të dhënat administrative. Kjo paraqet blerjen e mallrave dhe shërbimeve si dhe konsumin e prodhimit vetanak.

Konsumi final i institucioneve joprofitabile, të cilat iu shërbejnë ekonomive shtëpiake (KF i IJPSHESH)

Në vlerësimet e BPV për vitet 2004-2007 ky konsum përfshinë Partitë politike dhe Organizatat jo qeveritare (OJQ).

Shpenzimet e konsumit final të tyre përfshijnë mallrat dhe shërbimet e kryera nga IJPSHESH dhe shpenzimet e bëra nga IJPSHESH për mallra dhe shërbime pa ndonjë transformim, me qëllim të konsumit të ekonomive shtëpiake si transfere sociale në natyrë.

Konsumi final i Qeverisë(KFQ)

Konsumi final i Qeverisë përfshinë mallrat dhe shërbimet të cilat iu ofrohen njësisive institucionale rezidente për plotësimin dhe kënaqjen e nevojave të tyre, qofshin ato individuale apo kolektive.

Burim kryesor i të dhënave për konsumin final të Qeverisë, janë të dhënat nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF).

Konsumi final i Qeverisë vlerësohet si shumë e Bruto vlerës së shtuar (BVSH) dhe konsumit të ndërmjetëm (KN).

Qeveria e Përgjithshme përfshinë Qeverinë Qendrore dhe Qeverinë Lokale.

Qeveria Qendrore përfshinë: Kuvendin, Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë, Gjyqet e tj. si dhe seksionet, departamentet ose agjencitë tjera. Qeveria Lokale përfshinë komunat.

B. Formimi i bruto kapitalit (FBK)

Formimi i bruto kapitalit është shuma e formimit të bruto kapitalit fiks dhe ndryshimeve në inventar.

$FBK = FBKF + \Delta$ në inventar

Formimi i bruto kapitalit fiks

Vlerësimi i formimit të bruto kapitalit fiks (FBKF) përfshinë posedimin e të gjitha aseteve të prekshme dhe përmirësimet kryesore në asete të prekshme jo prodhuese. Vlerësimet e FBKF përfshijnë këto lloje të aseteve: banesat, ndërtesat tjera dhe strukturën, makinerinë dhe pajisjet.

Ndryshimet në inventar

Ndryshimet në inventar maten me vlerën e hyrjes së mallit në inventar, të zvogëluar për vlerën e tërheqjes dhe të ndonjë dëmi të mallit të shkaktuar gjatë mbajtjes së tij në inventar.

C. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve (E)

Eksporti i mallrave dhe shërbimeve përfshinë transaksionet e mallrave dhe shërbimeve (shitjet, shkëmbimin, dhuratat ose grantet) nga rezidentët tek jo rezidentët.

Të dhënat e eksportit janë marrë nga Dogana e Kosovës të shprehura në vlerën f.o.b. (free of board). Të dhënat e eksportit të shërbimeve janë marrë nga Bilanci i pagesave (BoP), i elaboruar në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK).

D. Importi i mallrave dhe i shërbimeve (I)

Importi i mallrave dhe i shërbimeve përfshinë transaksionet e mallrave dhe shërbimeve (shitjet, shkëmbimin, dhuratat ose grantet) nga jorezidentët tek rezidentët.

Vlera e importit të mallrave regjistrohet në doganën e Kosovës në vlerën c.i.f. (cost, insurance, freight) , e cila përfshinë transportin dhe sigurimin në doganën e shtetit eksportues dhe doganës së Kosovës.

Të dhënat e importit të shërbimeve janë marrë nga Bilanci i pagesave (BoP), i elaboruar në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK).

Shtojca Nr. 1: Vlerësimi i konsumit privat të ekonomive shtëpiake

I. Metodologjia

Vlerësimet për konsumin e ekonomive shtëpiake janë kryer përmes tre hapave (veprimeve):

Në hapin e parë te gjitha përgjigjet janë filtruar dhe përgjigjet me kualitet të dobët janë eliminuar.

Në hapin e dytë rezultatet janë agreguar sipas artikujve dhe janë matë me numrin e përgjithshëm të popullsisë.

Në hapin e tretë për te qenë sa më të besueshme rezultatet e agreguara për grupe te caktuara te produkteve janë plotësuar me te dhëna nga burime tjera.

Janë përdorë te dhëna tjera ekonomike , si të dhënat nga prodhimi, tregtia e jashtme , të dhënat nga bujqësia, tatimi mbi vlerën e shtuar dhe te dhënat tjera (ato nga anketa e bizneseve). Të dhënat nga importi janë burimi kryesor i te dhënave për konsumin privat të mallrave në ekonomi shtëpiake. Të dhënat nga tatimet dhe ato te kompanive të mëdha janë përdorë për prodhimin vendor të mallrave dhe shërbimeve në veçanti. Detajet e mëtutjeshme sqarojnë këtë qasje.

A. Filtrimi

Hapi i parë filtron përgjigjet kualitative nga anketa duke vlerësuar besueshmërinë e konsumit të mallrave si artikullin më të shpeshtë të konsumit. Analiza e të dhënave të anketës së 2400 ekonomive shtëpiake tregon një shkallë të lartë të mos përgjigjeve; psh 40% e ekonomive shtëpiake nuk raportojnë se shpenzojnë bukë dhe 34% e tyre konsumojnë më pak e 1200 kcal për kokë banori. Megjithatë vetëm për përgjigjet të cilat e kanë përmbushë njërin nga kushtet e cekura janë caktuar dy grupe kriteresh.

Kufiri i parë: Shpenzimet e konsumit prej 35€ ose më shumë për muaj.

Të gjitha përgjigjet që e përmbushin këtë kriter(35€ për kokë banori në muaj) janë konsiderua si përgjigje të vlefshme. Ky kufi është përcaktua ne bazë të shportës së konsumit siç është definuar në Ministrinë e Financave (MEF). Sipas Ligjit N 2002/1. Çmimi i shportës së konsumit shërben për te përcaktuar nivelin e ndihmave sociale. Kufiri prej 35 € është i nxjerrë nga niveli i beneficioneve prej 41 € për të rritur e caktuar ne vitin 2005, sipas faktorit prej 0.85, e cila tregon ekuivalentin e konsumit për të rritur.

Kufiri i dytë: Konsumi i ushqimit prej 2100 kcal ose më shumë për person në ditë. Duke përdorë shpenzimet e artikujve ushqimor dhe çmimet nga IÇK, të dhënat në sasi janë përdorë për çdo artikull. Në bazë të përbërjes së kalorive për çdo produkt, të dhënat e konsumit të kalorive ditore për kokë banori janë shpërndarë. Kufiri prej 2100 kcal është nxjerrë nga konsumi mesatar botëror i kalorive, i paraqitur me poshtë si konsum aktual mesatar i shteteve të zhvilluara dhe atyre në tranzicion.

B. Qasja e rrjedhjes së mallit

Qasja e rrjedhjes së mallit e harmonizon shkallën e përgjithshme të konsumit të ekonomive shtëpiake më të dhëna nga burime tjera, të cilat janë shpjeguar si me poshtë.

Te dhënat e importit/ eksportit

Të dhënat e tregtisë së jashtme janë të dhëna administrative të mbledhura nëpërmjet doganave, nëpërmjet një Dokumenti të thjeshtë administrativ. Besueshmëria e të dhënave të doganave është rritë dukshëm dhe është njeri nga burimet më të besueshme të të dhënave ekonomike në Kosovë. Megjithatë të dhënat e importit janë burim kryesor i informatave për vlerësimin e konsumit privat të ekonomive shtëpiake, të investimeve dhe konsumit të ndërmjetëm për prodhimet të cilat nuk prodhohen në vend. Importi i mallrave i regjistruar përmes dokumentit të thjeshtë administrativ është i vlerësuar me CIF (kostoja, sigurimet, transporti).

Duke përdorë tabelat koresponduese të sistemit të harmonizuar, klasifikimit të konsumit individual sipas qëllimit (COICOP), klasifikimit të produkteve qendrore dhe klasifikimit të gjerë të kategorive ekonomike (BEC), importi është kategorizuar sipas kategorive kryesore të llogarive kombëtare (në konsum final të ekonomive shtëpiake, formimin e kapitalit bruto fiks dhe konsum të ndërmjetëm).

Të dhënat e bujqësisë

Të dhënat e bujqësisë për numrin e kafshëve (viçave, demave, lopëve qumështore) dhe të mbjellave janë shfrytëzuar me qëllim të bashkërendimit të konsumit dhe për gjetjen e indikatorëve të vëllimit për vitin 2005, 2006 dhe 2007. Të dhënat janë bazuar në anketën e bujqësisë të organizuar në ESK çdo vit.

Të dhënat nga tatimet

Të dhënat për tatimet janë marrë nga Autoriteti tatimor, i cili përfshinë deklaratat mujore të tatimit mbi vlerën e shtuar, formularët tremujor të të ardhurave për korporatat e mëdha dhe të vogla dhe ato individuale. Të dhënat për tatimin në pronë të shtëpive dhe banesave sipas komunave janë marrë nga MEF dhe janë përdorë për vlerësimin e qirasë së përlllogaritur të tyre.

II. Vlerësimi i Konsumit të Ekonomive Shtëpiake

Filtrimi i të dhënave të ABESH na shpie deri të vlerësimet e reja të konsumit të ekonomive shtëpiake. Varësisht nga të dhënat tjera të mundshme për secilin grup artikujsh, janë bërë azhurnime siç vijon më poshtë:

A. Ushqimi

Konsumi i ushqimit në mënyrë të përmblodhur vjen nga filtrimi i mostrës. Gjatë filtrimit të dhënat nga importi në nivelin pesëshifror të COICOP janë krahasuar me të dhënat e nxjerra nga ABESH. Për produktet si: orizi, sheqeri, frutat agrume, kafja , të cilat nuk prodhohen tek ne, janë marrë vetëm të dhënat nga importi. Për artikujt tjerë , kur importi është më i madh se konsumi, janë bërë azhurnime në mënyrë që të bëhet vlerësimi i konsumit.

Rezultatet më të sakta janë nxjerrë edhe me kontrollin e të dhënave të bujqësisë. Numri i kafshëve është përdorë për të krahasuar konsumin e mishit. Shifrat nga prodhimi vendor nga tabela e mësipërme janë të përafërta me të dhënat e prodhimit të mishit nga anketa e bujqësisë. Të njëjtat vlejën edhe për prodhimin e qumështit.

B. Alkooli dhe duhani

Konsumi i këtij lloj grup malli është marrë kryesisht nga të dhënat e importit si dhe nga Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) nga prodhuesit e verës, birrës dhe cigareve.

Një kontrollë shtesë është bërë në konsumin e cigareve, duke marrë të dhënat nga ABESH për konsumin ditor të tyre. Të dhënat nga importi dhe prodhimi vendor janë shfrytëzuar në anën e furnizimit. Duke përdorë çmimin mesatar për cigaret e prodhuara dhe të importuara, është nxjerrë numri i përgjithshëm i pakove.

C. Veshjet dhe mbathjet

Veshjet dhe mbathjet paraqesin të vetmin grup të mallit , për të cilin të dhënat nga anketa janë më të mëdha se sa nga importi. Produktet e veshjes kryesisht importohen me çmim të ultë dhe dallimet mund të shpjegohen me marzhën tregtare në tregtinë me pakicë, e cila sillet në mes 80 dhe 100%.

D. Banimi

Konsumi i azhurnuar në këtë grup është përafërsisht identik me vlerësimet e më parme , me përjashtim të disa adaptimeve të vogla për importin e benzines dhe lëndëve djegëse. Materialet e përdorura për mirëmbajtje dhe riparim të ndërtesave dhe shërbimet për mirëmbajtje dhe riparim të ndërtesave janë përfshirë në qiranë e llogaritur të pronarëve të shtëpive.

Të dhënat për konsumin e energjisë elektrike janë marre nga KEK, prodhimi i energjisë dedikuar ekonomive shtëpiake.

E. Furnizimi

Blerjet e rralla të mallrave të qëndrueshme si dhe të dhënat e importit janë përdorë për vlerësimin e shpenzimeve të konsumit të mobileve. Të dhënat e importit në mënyrë domethënëse tejkalojnë shpenzimet e furnizimit të raportuara në ABESH.

F. Shëndetësia

Të dhënat e produkteve farmaceutike, produktet tjera mjekësore, dhe të gjitha aplikimet terapeutike janë marrë nga importet dhe korrigjuar në bazë të shpenzimeve të Qeverise së përgjithshme për barëra të siguruara nëpërmjet spitaleve.

G. Transporti

Të dhënat e importit janë përdorë për të përfituar konsumin e mallrave (veturave, pjesëve rezervë, dhe lëndët djegëse). Tetëdhjetë për qind (80%) e importeve të benzinës dhe tridhjetë për qind (30%) e importeve të naftës janë klasifikuar si konsum privat i ekonomive shtëpiake në të gjitha vitet. Shpenzimet për shërbime dhe transport të udhëtarëve janë marrë nga ABESH dhe harmonizuar me të dhënat e autoriteteve tatimore.

H. Komunikimi

Konsumi i “shërbimeve telefonike” fitohet duke përdorë tatimin mbi vlerën e shtuar nga PTK. Dy të tretat e shërbimeve telefonike, supozohet se shpenzohen nga ekonomitë shtëpiake, derisa një e treta nga sektori i biznesit. Të dhënat e importit janë burim kryesor për konsumin e pajisjeve telefonike.

I. Rekreacioni dhe kultura

Pjesa më e madhe artikujve në këtë grup është marrë nga të dhënat e importit. Prodhimi i brendshëm përfshinë, gazetatat dhe lojërat e fatit. Rezultatet e ABESH janë krahasuar me të dhënat e tatimeve.

J. Arsimi

Të dhënat për edukim janë marrë nga ABESH të cilat qëndrojnë mjaft konstante nëpër të gjitha vitet.

K. Hotelet dhe restorantet

Të dhënat tatimore janë burimi kryesor për konsumin në shërbimet hoteliere dhe restorante, të marra si të vlefshme me të dhënat e ABESH.

L. Të ndryshme

Konsumi i artikujve të ndryshëm përfshinë të dhënat nga ABESH dhe të dhënat nga importi.

Shtojca nr 2

Trajtimi i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në Statistikat e Llogarive Kombëtare

Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) është njësi e Kombeve të Bashkuara, është organizatë ndërkombëtare. Si rregull, Sistemi i Llogarive Kombëtare 1993 (SLLK 1993) i konsideron organizatat ndërkombëtare si ofrues të shërbimeve në mbarë botën sipas marrëveshjeve kontraktuese dhe si të tilla si jo-rezidentë të asnjë shteti (SNA 1993, paragrafi 4.164(b) dhe 4.165). Megjithkëtë, UNMIK-u është organizatë ndërkombëtare e veçantë për dy arsye. E para, është krijuar për të ofruar shërbime qeveritare vetëm për rezidentët e Kosovës, e jo botës si tërësi. E dyta, ishte caktuar të qëndrojë për një periudhë të caktuar e jo të papërcaktuar.

Me këtë varg të fakteve, ekzistojnë dy qasje të mundshme për të trajtuar UNMIK-un në llogaritë kombëtare të Kosovës. Sipas vështrimit të parë, të dhënat e publikuara e trajtojnë UNMIK-un si organizatë e veçantë ndërkombëtare, e cila kryen shërbime qeveritare për rezidentët. Sipas vështrimit të dytë, i cili mund të zbatohet në përpilimin e llogarive kombëtare, është që UNMIK-u, si organizatë e rëndomtë ndërkombëtare, është duke ofruar shërbime për botën në tërësi.

Sipas trajtimit të parë, shërbimet që ndërlidhen me UNMIK-un konsiderohen që janë prodhuar brenda vendit, pasi që ato prodhohen dhe konsumohen brenda territorit ekonomik të Kosovës për përfitime të Kosovës. Si shërbime jo tregtare, vlera e tyre kalkulohet me kosto të prodhimit si shumë e:

- (a) kompensim i punonjësve rezidentë dhe konsum i kapitalit fiks; dhe
- (b) shpenzim i konsumit të ndërmjetëm për mallra dhe shërbime (me kosto të punonjësve jorezident të regjistruara si import i shërbimeve). Financimi i këtyre shërbimeve regjistrohet njëjtë sikurse transferet aktuale nga jashtë.

Sipas trajtimit të dytë, Bruto Prodhimi Vendor (BPV) i Kosovës nuk do të regjistrojë as prodhimin e as konsumin për shërbimet qeveritare të Kosovës që ndërlidhen me UNMIK-un. Në vend të kësaj, Kosova do të regjistronte fitimet e punonjësve rezident të UNMIK-ut në Kosovë si të ardhura primare nga jashtë.

Sipas trajtimit të parë, për gjëra tjera të barabarta, Bruto Prodhimi Vendor (BPV) i Kosovës do të përfshijë prodhimin e shërbimeve qeveritare që ndërlidhen me UNMIK-un, me cilindo financim nga jashtë që vazhdon të pasqyrohet si transfer aktual, për aq gjatë sa UNMIK-u i ofron këto shërbime. Deri atëherë kur qeveria e Kosovës merr përsipër ofrimin e këtyre shërbimeve, ndërsa ofrimi nga UNMIK-u zbrit, zvogëlimi i BPV-së është rezultat i ndikuar nga rritja e BPV-së se mëhershme.

Sipas trajtimit të dytë, për gjëra tjera të barabarta, deri atëherë kur qeveria e Kosovës të merr përsipër funksionet e UNMIK-ut, BPV-ja e Kosovës do të rritet dhe tregon rritjen e shërbimeve qeveritare. Derisa UNMIK-u i ul ndikimet e tij, të ardhurat primare nga jashtë do të ulen në mënyrë të njëtrajtshme. Çfarëdo ngritje në financim të jashtëm për të ndihmuar Qeverinë e Kosovës për të marrë përsipër prodhimin e këtyre shërbimeve do të tregohet si ngritje në transfere aktuale nga jashtë.

Gjatë periudhës së tranzicionit, trajtimi i parë i UNMIK-ut, si organizatë e veçantë ndërkombëtare, prodhon GDP-në më të lartë për Kosovën sesa trajtimi i UNMIK-ut si organizatë e rëndomtë ndërkombëtare. Derisa ndikimi i UNMIK-ut zbret, përlllogaritjet e BPV-së nga të dy trajtimet do të jenë në nivel të njëjtë.

Enti i Statistikës së Kosovës përshkrim i shkurtër

Enti i Statistikës së Kosovës, është Ent profesional, vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Enti ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike. Enti financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

Enti i Statistikës së Kosovës vepron sipas Rregullores 2001/14 e cila ka hyrë në fuqi me 2 Korrik 2001. Një Master Plan afatmesëm është duke u përgatitur për zhvillimin e sistemit statistikor kompatibil me Statistikat Evropiane.

Struktura organizative e ESK-së, katër *Departamente prodhuese* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të popullsisë, Departamenti i statistikave sociale dhe Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe ambientit), *shtatë Zyra Rajonale* (Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe Ferizaj), *dy Departamente mbështetëse* (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative dhe Departamenti i administratës), si dhe *Zyra e regjistrimit të popullsisë*, përbëjnë ndërtimin struktural të ESK-ës.

Të punësuar janë gjithsej 134 punëtorë, prej tyre, 96 (71.6%) në seli të Entit, gjersa në Zyrat Rajonale, 38 (28.4%) .

Kemi mbështetje dhe bashkëpunim profesional me institucionet ndërkombëtare.

Enti i Statistikës së Kosovës ka një terren krejtësisht të mbuluar në shkallë vendi. Për implementim e Anketave në terren përdorim mostrën dhe metodologjinë adekuate. Gjatë grumbullimit të raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale.

Një ekip i ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtar janë duke punuar në projektin e regjistrimit të popullsisë.

Misioni i Entit, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: Enti i Statistikës së Kosovës, Rr."Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë**
- **Telefonat: Qendra kryesore: +381 (0) 38 235 111**
Drejtori: +381 (0) 38 235 545
- **Fax: +381 (0) 38 235 033**
- **E-mail: ekonomik@ks-gov.net**
- **Ueb-faqe: www.ks-gov.net/esk**